



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të dispozitave të nenit 3, pika 3.1, shkronja (p) e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/45 për vetëqeverisjen e komunave në Kosovë, të dispozitave të nenit 19 pika 19.1, shkronja (l) të Statutit të Komunës së Prishtinës, të dt. 16 mars 2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 30.05.2006, miratoi

R R E G U L L O R E N P Ë R S I G U R I M I N D H E M I R Ë M B A J T J E N E V A R R E Z A V E

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

1.1 Me këtë rregullore përcaktohen rregullat e varrimit të të vdekurve, rregullimi dhe qitja e varrezave jashtë përdorimit, mirëmbajtja e varrezave si dhe kushtet tjera lidhur me kryerjen e shërbimeve të varrimit në territorin e komunës së Prishtinës (në tekstin e mëtejshëm: komuna).

1.2 Rregullimi dhe mirëmbajtja e varrezave dhe varrimi është veprimtari komunale e interesit të përgjithshëm.

Neni 2

2.1. Varrezat janë hapësirë e rrethuar e tokës, e cila me planin urbanistik përkatës është caktuar për varrimin e të vdekurve, në të cilat gjenden objektet përcjellëse dhe infrastruktura komunale.

2.2. Me objektet përcjellëse, në kuptim të kësaj rregulloreje, nënkuptohet krematoriumi, morgu, lokalet për përgatitjen dhe përcjelljen e kufomës së të vdekurit e të ngjashme.

2.3. Varrezat mund të jenë të përgjithshme (publike) dhe të veçanta.

2.4. Varreza të veçanta konsiderohen varrezat përkujtimore dhe varrezat e bashkësive të caktuara fetare.

2.5. Varrezat e veçanta mund të rregullohen si pjesë e ndarë e varrezave të përgjithshme.

Neni 3

3.1. Dimensionimi i varrezave behët sipas nevojave për vendvarrime në bazë të të dhënave për varrimet ditore apo vjetore, duke pas parasysh territorin gravitues dhe numrin e banorëve dhe vdekshmërinë.

3.2. Sipërfaqet e nevojshme të vendvarrimeve përcaktohen në bazë të numrit të varrimeve, tipit dhe numrit të vendvarrimeve dhe sipërfaqes së nevojshme për vendvarrim, si dhe sipërfaqes për përmbajtje tjera.

3.3. Me rastin e përcaktimit të sipërfaqes për nevojat e varrezave duhet llogaritur bruto dhe neto sipërfaqen e varrezave.

Neni 4

4.1. Varrezat duhet vendosur në vend të përshtatshëm dhe mjaft të madh i cili, ambientalisht dhe sipas konfiguracionit të terrenit, është i përshtatshëm për varrim, sipas rregullit jashtë ose në skaj të vendbanimit, e në afërsi të rrugës me shtegun e ndarë për këmbësorë.

4.2. Hapësira për varreza duhet të përmbushë këto kritere:

1. Përshtatshmëria natyrore për varrim: përbërja e dheut (kullueshmëria, stabiliteti), niveli i ujërave nëntokësore, i cili duhet të jetë së paku 50 cm nën kotën më të ulët të varrit dhe përshtatshmëria e konfiguracionit (pa pjerrtësi të mëdha dhe qëndrim të ujërave sipërfaqësore);
2. Pozita sipas kushteve natyrore: jashtë rrjedhave të ujërave nëntokësore dhe mbitokësore, jashtë territorit vërshues, si dhe jashtë pjesëve të mbrojtura të natyrës dhe zonave të maleve.

Neni 5

5.1. Varrezat ose pjesë të tyre qiten jashtë përdorimit me vendimin e Kuvendit të Komunës, atëherë kur më nuk ka mundësi të varrimit për shkak të mungesës së vendit, kushteve sanitare apo kushteve të tjera.

5.2. Kuvendi i Komunës mund të nxjerrë vendimin për zhvendosjen e varrezave, ose pjesës së tyre që janë jashtë përdorimit, me kusht që zhvendosja dhe varrimi i mëtejshëm të sigurohet me ndërtimin e varrezave të reja ose në varrezat tjera ekzistuese.

5.3. Zhvendosja e varrezave apo e pjesës së tyre, mund të behët pas kalimit të njëqind vjetëve prej varrimit të fundit.

5.4. Shpenzimet e zhvendosjes së varrezave apo pjesës së tyre i bartë Komuna.

Neni 6

6.1. Varrimin, rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave, nga neni 2, paragrafi 1 i kësaj rregulloreje, në qytetin e Prishtinës e bënë ndërmarrja publike komunale, të

cilën Kuvendi i Komunës së Prishtinës e themelon për ushtrimin e kësaj veprimtarie komunale.

6.2. Rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave në fshat e bënë këshilli i fshatit.

6.3. Ushtrimin e veprimtarisë, nga paragrafi 1 i këtij neni, Komuna mund t'ia besojë ndërmarrjes tjetër, përkatësisht operatorit, me kontratë në bazë të tenderit.

Neni 7

Ndërmarrja e themeluar për ushtrimin e kësaj veprimtarie komunale, ndërmarrja tjetër, përkatësisht operatori, të cilës i besohen punët e veprimtarisë komunale (më poshtë: ndërmarrja, përkatësisht operatori) është e obliguar që në punën e saj, në tërësi, t'i përmbahet ligjit dhe dispozitave të kësaj rregulloreje.

II. RREGULLIMI DHE MIRËMBAJTJA E VARREZAVE

Neni 8

Rregullimi dhe mirëmbajtja e varrezave, në kuptim të kësaj rregulloreje, nënkupton pajisjen e hapësirës për varrim, rregullimin, pajisjen dhe mirëmbajtja e objekteve dhe përmbajtjeve tjera në varreza, të cilat shërbejnë për kryerjen e shërbimit të varrimit (krematoriumi, morgu, WC-të publike, krojet publike e të ngjashme), rregullimi dhe mirëmbajtja e rrugëve dhe shtigjeve brenda varrezave dhe hapësirës në mes të varreve, mirëmbajtja e gjelbërimit, ndriçimit publik, e pastërtisë dhe e rendit në varreza, largimi i borës dhe akullit brenda varrezave si dhe punëve tjera që kanë të bëjnë me rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave, varreve dhe simboleve mbi varre.

Neni 9

9.1. Rregullimi dhe mirëmbajtja e varrezave behët sipas programit vjetor të rregullimit dhe mirëmbajtjes të cilin e nxjerrë ndërmarrja, përkatësisht operatori, deri më 31 dhjetor të vitit vijues për vitin pasues, me pëlqimin paraprak të Bordit të Drejtorëve të Kuvendit të Komunës.

9.2. Programi nga paragrafi 1 i këtij neni përmban: llojin, vëllimin dhe dinamikën e punëve, si dhe lartësinë e mjeteve të nevojshme për realizimin e tij.

9.3. Ndërmarrja, përkatësisht operatori është e obliguar që Drejtoratit të Inspektionit t'i dërgojë planin e mirëmbajtjes së varrezave sipas muajve për vitin vijues, në afat prej 10 ditësh prej nxjerrjes së programit nga paragrafi 1 i këtij neni. Këto plane duhet të harmonizohen me programin e përcaktuar nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 10

10.1. Me planin urbanistik dhe projektin e varrezave, hapësira e paraparë për varrim ndahet në parcela brenda të cilave gjenden vendvarrimet. Parcelat dhe vendvarrimet shënohen më numra.

10.2. Vendvarrimi, në kuptim të kësaj rregulloreje, nënkupton varrin, varrin e përbashkët (familjar) dhe vendin për vendosjen e urnës me hirin e kremimit të mbetjes mortore (kufomës).

10.3. Ndërmarrja, përkatësisht operatori, është i obliguar të mbajë evidencën e vendeve të varreve me emrat e personave të varrosur dhe datën e varrimit, evidencën për vendosjen e urnës dhe bartjen e mbetjeve mortore dhe evidenca të tjera lidhur me ushtrimin e kësaj veprimtarie komunale.

Neni 11

Për mirëmbajtjen e vendvarrimeve dhe simboleve mbi varre kujdesen vet familjarët dhe familja e tyre, të cilët rregullimin dhe mirëmbajtjen e vendvarrimeve mund t'ia besojnë ndërmarrjes e cila merret me veprimtari të varrimit.

Neni 12

12.1. Për vendosjen, riparimin dhe heqjen e përmendores dhe sendeve të tjera në vendvarrim është e nevojshme leja me shkrim e ndërmarrjes.

12.2. Për ndërmarrjen e çfarëdo veprimi në përmendore apo objekt tjetër në varreza, apo në vendvarrim i cili ka cilësinë e përmendores së kulturës, paraprakisht duhet të merret pëlqimi me shkrim nga institucioni kompetent për mbrojtjen e përmendoreve të kulturës.

12.3. Ndërmarrja, përkatësisht operatori, është e obliguar që të njoftojë inspektorin komunal për kryerjen e punëve pa pëlqimin, nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni.

Neni 13

13.1. Punët e zanatit në varreza, për të cilat është marrë pëlqimi në kuptim të nenit 12 të kësaj rregulloreje, mund të kryhen me këto kushte:

1. - që të kryhen në ditë të punës, në mënyrë që, në shkallën më të lartë, të ruhet qetësia dhe dinjteti i varrezave,
2. - që materiali ndërtimor (rëra, zhavorri, dërrasat, etj.) të mbahen në varreza vetëm atëherë sa është e domosdoshme për kryerjen e punëve, në mënyrë ashtu që të mos pengohet prania dhe lëvizja e vizitorëve në varreza, e në rast të ndërprerjes dhe përfundimit të punëve kryerësi i punëve, është i obliguar që vendpunimin pa zvarritje ta kthejë në gjendje të mëparshme,
3. - për bartjen e materialit të nevojshëm për kryerjen e punëve të zanatit në varreza mund të shfrytëzohen vetëm rrugët dhe shtigjet të cilat i cakton ndërmarrja, përkatësisht operatori,
4. - nëse gjatë kryerjes së punëve haset në pjesë të arkivolit, eshtra e të ngjashme, punët duhet të ndërpriten menjëherë, dhe për këtë të njoftohet ndërmarrja, përkatësisht operatori,

5. - nëse gjatë kryerjes së punëve gjenden sende me vlerë, ato duhet menjëherë t'i dorëzohen ndërmarrjes përkatësisht operatorit,
6. - vendet e rrjedhës së ujit, pas përdorimit duhet mbyllur, kurse veglat e punës nuk duhet të lahen në krua.

13.2. Ndërmarrja, përkatësisht operatori mund të ndalojë kryerjen e punëve të zanatit në varreza ose në pjesë të varrezave në kohë të caktuar të ditës, në ditë të caktuara ose në kohë të caktuar të vitit.

13.3. Kryerësit të punëve të zanatit i cili nuk iu përmbahet dispozitave të këtij neni dhe dispozitave tjera për rendin në varreza, ndërmarrja, përkatësisht operatori mund t'i ndalojë punimet në varreza.

Neni 14

Ndërmarrja, përkatësisht operatori mund t'i largojë sendet dhe të mbjellat, vendosja, përkatësisht mbjellja e të cilave është e ndaluar me këtë rregullore dhe këtë me shpenzime të familjarëve të shfrytëzuesit të vendit të varrimit.

Neni 15

15.1. Në varreza është e ndaluar ngritja dhe vendosja në varreza e simboleve dhe shenjave të tjera, të cilat nuk janë në lidhje me personat e varrosur në varreza.

15.2. Është e ndaluar vendosja e simboleve, përmendoreve dhe përkujtimeve në vendvarrime të cilat me dukjen, shenjat apo mbishkrimet, ofendojnë ndjenjat patriotike, fetare, nacionale dhe ndjenjat tjera të qytetarëve.

I. VARRIMI

a/ Të përgjithshme

Neni 16

Me varrimin, në kuptim të kësaj rregulloreje, nënkuptohet varrimi i mbetjes mortore, përkatësisht kremimi i mbetjes mortore dhe vendosja ose derdhja e hirit në vend të caktuar, si dhe veprimet tjera të cilat ndërmerren me këtë qëllim.

Neni 17

Varrezat në të cilat do të varrosen mbetjet mortore të të vdekurve ose do të vendosen urnat, e cakton ndërmarrja, përkatësisht operatori dhe këtë sipas rregullit, sipas territorit në të cilin i vdekuri ka pasur vendbanimin para vdekjes, përkatësisht në ato varreza në të cilat ka vend për varrim, përveç nëse ka qenë shfrytëzues i vendvarrimit në varreza tjera.

Neni 18

Ndërmarrja, përkatësisht operatori, transporton mbetjen mortore të të vdekurit në varreza ku do të varroset.

Neni 19

19.1. Ndërmarrja, përkatësisht operatori është e obliguar që të sigurojë çdo ditë të javës shërbimet për varrimin e të vdekurve.

19.2. Personat të cilët bëjnë varrimin mbajnë uniformën përkatëse të cilën e siguron ndërmarrja, përkatësisht operatori.

b/ Shfrytëzimi i vendvarrimit

Neni 20

20.1. Vendvarrimin, nga paragrafi 2 i nenit 10 të kësaj rregulloreje, e jep në shfrytëzim ndërmarrja, përkatësisht operatori në kohë të pacaktuar me kompensim, dhe për këtë nxjerrë aktvendim.

20.2. Kundër aktvendimit nga paragrafi 1 i këtij aktvendimi, personi i interesuar mund të ushtrojë ankesë Drejtoratit të Shërbimeve Publike, Transportit, Mbrojtjes së Ambientit dhe të Tokës Ndërtimore (më tutje: Drejtorati).

20.3. Për shfrytëzimin e vendvarrimit shfrytëzuesi paguan kompensimin vjetor.

20.4. Lartësinë e kompensimit, nga paragrafi 1 dhe 3 i këtij neni e përcakton ndërmarrja, përkatësisht operatori, me pëlqimin paraprak të Drejtoratit të Ekonomisë.

Neni 21

21.1. Të drejtën e shfrytëzimit të vendvarrimit, përveç shfrytëzuesit të vendvarrimit, e kanë edhe anëtarët e familjes së të vdekurit.

21.2. Pas shfrytëzuesit të vendvarrimit, të drejtën e shfrytëzimit të vendvarrimit e fitojnë pasardhësit e tij.

Neni 22

Ndërmarrja, përkatësisht operatori, është e obliguar të mbajë dhe të ruaj regjistrin e personave të vdekur sipas emrit, mbiemrit, emrit të babait, numrit personal të qytetarëve të personit të vdekur me shënimin se ku është varrosur.

c/ Kremimi

Neni 23

23.1. Kremimi i të vdekurit behët në krematorium.

23.2. Kremimi i mbetjes mortore të të vdekurit behët nëse i vdekuri për së gjalli, me shkrim apo në ndonjë mënyrë tjetër të padyshimtë, e ka shprehur dëshirën për këtë.

23.3. Kremimi i mbetjes mortore të të vdekurit behët edhe me kërkesën e personit i cili kujdeset për varrimin e të vdekurit, nëse i vdekuri për së gjalli, nuk ka lënë testament për mënyrën e varrimit.

23.4. Gjatë punës së krematoriumit ndërmerren masa përkatëse sanitare dhe teknike me të cilat pengohet ndotja e ajrit.

Neni 24

Ndërmarrja, përkatësisht operatori, me rastin e caktimit të ditës së kremimit sipas rregullit, njëkohësisht cakton edhe ditën dhe kohën e varrimit përkatësisht të vendosjes së urnës, për çka, me shkrim njofton personin i cili kujdeset për varrim, me vërejtjen se varrimi, përkatësisht vendosja e urnës, do të behët edhe pa pranin e tij.

Neni 25

Hiri i mbetjes mortore të të vdekurit nuk guxon as përkohësisht t'i jepet anëtarëve të familjes ose personave tjerë, përveç kur sjellin prova se e kanë të siguruar vendvarrimin në vend tjetër.

RENDI NË VARREZA

Neni 26

26.1. Në varreza mbahet rend dhe qetësi e plotë.

26.2. Ndërmarrja, përkatësisht operatori është e obliguar të sigurojë mbajtjen e rendit dhe qetësinë në varreza.

Neni 27

27.1. Varrezat janë të hapura për vizitorë çdo ditë, dhe këtë në periudhën prej 1 prillit deri më 30 shtator prej orës 7,00 deri në orën 19,00, kurse prej 1 tetorit deri me 31 mars prej orës 7,00 deri në orën 18,00.

27.2. Ndërmarrja, përkatësisht operatori për shkaqe të arsyeshme, përkohësisht mund të ndalojë vizitat në varreza.

Neni 28

Në varreza është e ndaluar:

1. - hyrja dhe qëndrimi jashtë kohës kur varrezat janë të hapura për vizitorë,
2. - qëndrimi i fëmijëve më të rinj se 10 vjeç pa përcjelljen e personit të rritur,

3. - kërcimi i rrethojës, shkelja e sipërfaqeve të gjelbëruara, thyerja e drurëve, këputja e luleve dhe të mbjellave tjera,
4. - shkelja, përlyerja dhe përdhosja e vendvarrimeve,
5. - shkaktimi i dëmeve në perkujtimoret mbi varreza dhe sendet tjera në vendvarrime,
6. - prishja e qetësisë në varreza,
7. - futja e kafshëve në territorin e varrezave,
8. - vozitja e biçikletës, motoçikletës dhe automjetit tjetër nëse kjo nuk është lejuar me leje të veçantë të ndërmarrjes, përkatësisht operatorit,
9. - shkaktimi i papastërtisë dhe të hedhja e luleve të veshkura në sipërfaqet e gjelbëruara, rrugë dhe shtigje,
10. - lënia e ushqimit në vendvarrime dhe në vende tjera në varreza,
11. - fotografimi në formë të profesionit dhe kryerja e shërbimeve tjera pa lejen e ndërmarrjes, përkatësisht operatorit,
12. - shitja e çfarëdo lloj malli pa lejen e ndërmarrjes, përkatësisht operatorit,
13. - hyrja në morg jashtë kohës së caktuar për varrim,
14. - ndezja e qirinjve në varre jashtë shtëpizës për qirinj,
15. - montimi i zhardinjerëve, shtëpizave për qirinj, rrethojave etj në platon e varrit, përkatësisht vendvarrimit nëse kjo nuk është paraparë me projektin për perkujtimore,
16. - mbjellja e drurëve përreth varreve dhe vendvarrimeve pa lejen e ndërmarrjes, përkatësisht operatorit.

Neni 29

Ndërmarrja, përkatësisht operatori është i obliguar që dispozitat e kësaj rregulloreje, me të cilat përcaktohet rendi në varreza, t'i vendosë në vend të dukshëm në hyrje të varrezave.

V. MJETET PËR KRYERJEN E VEPRIMTARISË KOMUNALE

Neni 30

30.1. Mjetet për kryerjen e veprimtarisë komunale të varrimit sigurohen nga kompensimi të cilin e paguajnë shfrytëzuesit e drejtpërdrejtë.

30.2. Mjetet për rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave sigurohen në buxhet nga kompensimi për shfrytëzimin e tokës ndërtimore nga mjetet e ndërmarrjes, përkatësisht operatorit nga kompensimi për shfrytëzimin e vendvarrimit, si dhe nga burime tjera në përputhje me ligjin.

Neni 31

31.1. Për varrim dhe shërbimet tjera lidhur me varrimin (transporti i të vdekurit dhe ceremoniali i varrimit etj.) ndërmarrja, përkatësisht operatori përcakton çmimin e shërbimeve, me pëlqimin paraprak të Drejtoratit të Ekonomisë.

31.2. Çmimi i shërbimeve nga paragrafi 1 i këtij neni, paguhet edhe me rastin e zhvarrosjes së mbetjeve mortore.

MBIKËQYRJA

Neni 32

32.1. Mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të kësaj rregulloreje dhe ligjshmërisë në punën e ndërmarrjes, përkatësisht operatorit, e bënë Drejtorati.

32.2. Punët e mbikëqyrjes inspektive për zbatimin e kësaj Rregulloreje dhe akteve tjera, të nxjerra në bazë të saj, i kryen Drejtoarti i Inspektionit.

VI. DISPOZITAT NDËSHKIMORE

Neni 33

33.1. Me gjobë prej 150,00 deri 1.500,00 € do të dënohet për kundërvajtje ndërmarrja, përkatësisht operatori nëse nuk vepron sipas dispozitave të nenit 9 pika 9.3, nenit 10 pika 10.3, nenit 12 pika 12.3, nenit 12 pika 12.3, neneve 15, 18, 19, 22, 23, 25, 26 pika 26.2, 27 pika 27.1 dhe nenit 29.

33.2. Për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni do të dënohet me gjobë prej 50,00 deri 150,00 € edhe personi përgjegjës në ndërmarrje, përkatësisht i operatorit.

Neni 34

34.1. Me gjobë prej 150,00 deri 1.500,00 € do të dënohet për kundërvajtje personi juridik i cili kryen punë të zanatit nga neni 12 dhe 13 i kësaj rregulloreje nëse:

1. - nuk siguron lejen dhe pëlqimin me shkrim të institucionit për mbrojtjen e monumenteve të kulturës, në kuptim të dispozitave të nenit 12 të kësaj rregulloreje,
2. - vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 13, të kësaj rregulloreje.

34.2. Për kundërvajtje nga paragrafi 1 pika 1 dhe 2 të këtij neni do të dënohet me gjobë prej 50,00 deri 150,00 € edhe personi përgjegjës në ndërmarrje.

Neni 35

Me gjobë prej 50,00 deri 150,00 € do të dënohet për kundërvajtje personi fizik i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 12, 13 dhe 14 të kësaj rregulloreje.

Neni 36

36.1. Me gjobë prej 300,00 € do të dënohet për kundërvajtje personi juridik dhe ndërmarrësi i cili kryen punët e zanatit kurse me gjobë prej 50,00 Euro personi përgjegjës i personit juridik dhe personi fizik për kundërvajtje nga neni 13 pika 13.1, i kësaj Rregulloreje.

36.2. Me gjobë prej 50,00 € do të dënohet personi fizik për kundërvajtje nga neni 28 i kësaj rregulloreje.

VIII. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 37

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet dispozita e nenit 3 pika 3.1 dhe neni 4 i Vendimit për organizimin e organizatës punonjëse komunale "Higjienoteknika" si Ndërmarrje Publike Komunale ("Gazeta Zyrtare e Kosovës", nr.30/90).

Neni 38

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit të tij.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01 Nr. 352-157/1, më 30.05.2006

K R Y E T A R I
Ismet Beqiri